



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e hënë, më 3 korrik 2023, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive, (AMA) u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Armela	KRASNIQI	Kryetar
Desada	METAJ	Zëvendëskryetar
Aurela	BICJA	Anëtar
Besian	ZOGAJ	Anëtar
Gjergji	HAMITI	Anëtar
Jetmir	HALILAJ	Anëtar
Joana	ALLUSHI	Anëtar

AMA, pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. Miratimin e rregullores “Mbi veprimtarinë, organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA)” (Vendimi nr. 49, datë 03.07.2023).
2. Miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Sekretariatit Teknik dhe përcaktimin e masës së pagesës për pjesëmarrje në Sekretariatin Teknik” (Vendimi nr. 50, datë 03.07.2023).
3. Miratimin e ndryshimeve të ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë “Top Gold” sh.p.k., e licencuar për subjektin audio privat lokal “Radio Top Gold” (Vendimi nr. 51, datë 03.07.2023).
4. Pranimin e kërkesës së shoqërisë “Albanian Satellite Communication” sh.p.k., për bashkimin me përthithje të shoqërisë “Bleta” sh.p.k., dhe konstatimin e pavlefshmërisë së autorizimit të shoqërisë “Bleta” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve, mbështetur në rrjet IP (IPTV) “Bleta” (Vendimi nr. 52, datë 03.07.2023).
5. Konstatimin e pavlefshmërisë së autorizimit të shoqërisë “Tris Optik” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tris Optik” (Vendimi nr. 53, datë 03.07.2023).
6. Pranimin e kërkesës së shoqërisë “Fabbtel” sh.p.k., për zgjerimin e zonës së shërbimit për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “TV Kabllor Fabbtel”, në Njësinë Administrative Dushk (Vendimi nr. 54, datë 03.07.2023).

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 3 korrik 2023